

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Heroina Shkëmbi

Mban pozicionin e Drejtoreshës së Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit që nga viti 2012. Më parë ka punuar si shefe finance te Qendra Kulturore Kuçovë, si punonjëse e Gjendjes Civile pranë Prefekturës Berat, Prefekturës së Qarkut, Rrethi Kuçovë dhe Këshillit të Rrethit.

Ka mbaruar Universitetin Bujqësor të Tiranës, dega Ekonomi Agrare.

Kujdeset dhe përpilon dokumentacionin e nevojshëm për hartimin e projekt-buxhetit si dhe organizon, mbikëqyrë dhe kontrollon zbatimin e buxhetit. Regjistron të gjitha të drejtat dhe detyrimet e institucionit dhe të institucioneve të varësisë, në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga Ministria e Financës.

Ndjek problemet e buxhetit duke u bazuar në ligjin për buxhetin e shtetit, ligjin për buxhetin vendor si dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave të hartuar për këtë qëllim. Gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre, drejtuesit dhe specialistët e kësaj drejtorie janë të detyruar të zbatojnë dhe mbikëqyrin zbatimin e parimeve të efektivitetit ekonomik dhe ato të drejtimit financiar, duke u kujdesur që fondet e miratuara të shpenzohen në kohën e duhur dhe vetëm me qëllimin e një administrimi ekonomik sa më efektiv.